

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“ Dritare” shpk

Në Tiranë, sot më datë M. 02.2019, ne të poshtëshënuarit:

- 1- Rudina Xhunga, e datëlindjes 22.06.1972, lindur në Vlore dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Leternjoftim ID, me numër personal H25622118R,

me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, kriojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Dritare” shpk**,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “Dritare”, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Sheshi Jozef San Martin, Pallati 18, Ap.24, Kodi postar 1019, Tiranë.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

1. Reklama online, reklama elektronike, Shkrime PR, sherbim televiziv.
2. Punime grafike, botime online dhe te printuar, publikime.
3. Ideim, projektim, përpunim, realizim.
4. Shërbim konsulencë, asistencë, audio, CD, video, rregjistreme.
5. Projekte, ideime dhe zbatime të ndryshme.
6. Shërbime të ndryshme marketingu, si dizajn, printime të ndryshme, organizim aktivitete të ndryshme promocionale, etj.
7. Organizim konferencash, trajnimesh, kurse profesionale, emisione televizive.
8. Çdo veprimtari tjetër ligjore që ka lidhje me objektet e mësipërme të

Veprimtarisë.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 10 000 lekë, i ndarë në 1 kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

Rudina Xhunga, zotëron 1 kuotë me vlerë 10 000 lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organë Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

- Rudina Xhunga, e datëlindjes 22.06.1972, lindur në Vlore dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal H25622118R, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtitje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortak themelues të shoqërisë tregtare "Dritare shpk", nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAK THEMELUES

The image shows two handwritten signatures. The first signature, "Rudina", is written below the name "Rudina Xhunga". The second signature, "Ortak Themelues", is written below the name "Ortak Themelues". Both signatures are cursive and appear to be in black ink on a white background.